



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1107/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Etor Hoxha kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Gjakovë nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër QNR-së – KQZ-së për shkak të mungesave të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Etor Hoxha kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Etor Hoxha kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Gjakovë nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me të cilën dyshon se në mos numërimin dhe në mos llogaritjen e votave në vendvotimin 0202X/14R; 0204C/03R ; 0201C/03R pasi që në rezultatet preliminare ka pasur 3 vota në klasën 0202X/14R ndërsa tash ka 2 vota, në klasën 0204C/03R në rezultatet preliminare ka pasur 6 vota ndërsa në ato përfundimtare ka 0 vota. Parashtruesi i ankesës kërkon që të rinumërohen vota në klasën 0201C/03R për shkak të diskrapancës së votave në mes të kandidatëve të partisë së tij.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e Etor Hoxha se i mungojnë votat , PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova të mjaftueshme për

ti vërtetuar pretendimet e tilla ankimore të parashtruara në ankesë pasi që në asnjë moment dhe me asnjë provë zyrtare nuk ka arritur që të dokumentoj votat e fituara dhe shpallura nga rezultatet preliminare, andaj provat e bashkangjitura nuk janë të mjaftueshme që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara me ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1107/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.